

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS  
MJETET PENSIONALE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

*Më dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2015*

---

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR .....	1-2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE .....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË MJETET NETO TË PJESËMARRËSVE .....	5
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË .....	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE .....	7-28

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### **Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale (FKPK-MP), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar deri më 31 dhjetor 2015, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në mjetet neto të pjesëmarrësve dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen korrekte të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

#### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është është që, bazuar në auditimin tonë të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës, të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të fitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të nevojshme për auditim, për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, këtu përfshihen dhe vlerësimi i rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive në pasqyrat financiare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

#### *Opinionit*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale më 31 dhjetor 2015, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

## Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014, janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur opinion të pakualifikuar për pasqyrat më 14 prill 2015, me një paragraf për theksim të çështjes duke tërhequr vëmendjen për shënimin e llogarive të pjesëmarrësve individual e cila përshkruan disa mjete të pranuar nga pjesëmarrësit që nuk atribuohen në llogaritë e pjesëmarrësve individuale.

Ky raport është përkthim i verzionit origjinal në gjuhën angleze. Në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

Prishtinë, Kosovë  
12 prill 2016

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
<b>Mjetet</b>			
Paraja në bankë	4	50,906,018	9,938,218
Kontributet e arkëtueshme	5	8,758,404	7,984,158
Investimet e disponueshme për shitje	6	1,084,732,950	1,023,619,618
Investimet që mbahen deri në maturim	7	95,654,197	54,701,478
		<b>1,240,051,569</b>	<b>1,096,243,472</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet ndaj FKPK-O	8	277,050	366,825
Detyrimet për aksionet e riblera	9	1,666,758	118,203
Jo-kontributet	10	16,029	13,688
		<b>1,959,837</b>	<b>498,716</b>
<b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b>		<b>1,238,091,732</b>	<b>1,095,744,756</b>

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK dhe nënshkruar në emër të tyre më 12 prill 2016.

Prof. Dr. Ymer Havolli  
 Kryesues i Bordit Drejtues

Z. Adrian Zalli  
 Drejtor Menaxhues

Z. Vërshim Hatipi  
 Zëvendësdrejtor - Financa dhe TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
<b>Të hyrat</b>			
Rivlerësimi i investimeve të disponueshme për shitje - neto	11	26,712,800	65,791,957
Të hyrat nga interesi i investimeve që mbahen deri në maturim	12	1,676,846	952,061
Të hyrat e tjera	13	1,165,138	-
		<b>29,554,784</b>	<b>66,744,018</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	14	(5,819,478)	(5,269,319)
		<b>(5,819,478)</b>	<b>(5,269,319)</b>
		<b>23,735,306</b>	<b>61,474,699</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Kontributet e Pjesëmarrësve	Fitimet e Mbajtura	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
<b>Më 1 Janar 2014</b>	<b>805,589,060</b>	<b>115,462,917</b>	<b>921,051,977</b>
Kontributet	128,862,934	-	128,862,934
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(12,256,211)	(2,022,630)	(14,278,841)
Riblerjet si pasojë e refondimeve	(1,201,279)	(164,734)	(1,366,013)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	61,474,699	61,474,699
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>920,994,504</b>	<b>174,750,252</b>	<b>1,095,744,756</b>
Kontributet	138,293,862	-	138,293,862
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(15,781,882)	(3,517,561)	(19,299,443)
Riblerjet si pasojë e refondimeve	(377,605)	(5,144)	(382,749)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	23,735,306	23,735,306
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,043,128,879</b>	<b>194,962,853</b>	<b>1,238,091,732</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operacionale</b>			
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve		23,735,306	61,474,699
<i>Lëvizja e kapitalit punues:</i>			
Rritja / (Zvogëlimi) i detyrimeve të pagueshme ndaj FKPK-0	8	(42,604)	26,846
Rritja e detyrimeve për jo-kontributet	10	2,341	354
<b>Rrjedhja neto e parasë nga operacionet</b>		<b>23,695,043</b>	<b>61,501,899</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese</b>			
(Rritja) në investimet e disponueshme për shitje		(61,113,332)	(372,786,997)
(Rritja) në investimet që mbahen deri në maturim		(40,952,719)	(1,578,573)
<b>Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>		<b>(102,066,051)</b>	<b>(374,365,570)</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
Kontributet e pranuar të pjesëmarrësve		137,519,615	128,748,014
Tërheqjet e kursimeve		(17,786,861)	(14,317,568)
Refondimet		(393,946)	(1,275,460)
<b>Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>		<b>119,338,808</b>	<b>113,154,986</b>
<b>Rritja / (Zvogëlimi) në para të gatshme dhe ekuivalentët e saj</b>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		9,938,218	209,646,903
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	4	<b>50,906,018</b>	<b>9,938,218</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## 1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (më tutje "FKPK"), regjistruar në adresën: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e amendamentuar me Rregulloren 2005/20, kjo më vonë e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-084 të Republikës së Kosovës, më tej e amendamentuar me Ligjin Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplimentuar me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 04/L-168; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të asetëve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e aniteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbesuar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). Secili pjesëmarrës ka llogari individuale në FKPK në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga ekspertë të investimeve dhe pensione, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Një anëtar pa të drejtë vote i përfaqëson interesat e Qeverisë.

Këto pasqyra financiare janë për FKPK – Mjetet pensionale (ose "FKPK- MP") i cili përbëhet nga kursimet pensionale (mjetet pensionale) të kontribuuesve. Pasqyrat financiare për FKPK- Operacionet (ose "FKPK-O"), i cili është subjekti i menaxhimit dhe administrimit të kursimeve pensionale (mjetëve pensionale) të kontribuuesve, janë përgatitur veçmas për pasqyrat financiare për mjetet e pensione.

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

### 2.1 Deklarata e përputhjes

Pasqyrat financiare të FKPK-MP janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

### 2.2 Bazat e përgatitjes

FKPK-MP i mbanë librat e kontabilitetit dhe i përgatitë pasqyrat financiare sipas konventës së kostos historike siç modifikohen nga rivlerësimi i mjetëve financiare të disponueshme për shitje. Shënimet aktuale dhe ato krahasuese janë të shprehura në euro, e cila është valuta funksionale dhe raportuese e FKPK-MP. Sipas nevojës, të dhënat krahasuese janë riklasifikuar me qëllim të përshtatjes me prezantimin e vitit aktual.

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

#### Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

##### i) Standardet e reja dhe Interpretimet në fuqi për periudhën aktuale

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Planet e përfitimit të definuara: Kontributet e punonjësve (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2010-2012)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2011-2013)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014)

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka dërguar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të FKPK-MP.

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (Vazhdim)

Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

ii) *Standardet, ndryshimet dhe Interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më parë nga FKPK-MP*

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standarde të reja, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese janë publikuar nga BSNK, por ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga FKPK-MP.

- **SNRF 9 "Instrumentet financiare"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018);
- **SNRF 14 "Llogaritë rregullatore të shtyrjes"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018);
- **IFRS 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019);
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtori të tij ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri një projekt kërkimor në metoda të kapitalit neto është përfunduar);
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Shpalosja e interesave në entitetet e tjera" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Njësitë Ekonomike Investuese: Aplikimi përjashtim Consolidation (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 January 2016);
- **Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"** - Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** - Iniciativa Disclosure (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme"** - Shpalosjet (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017);
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat"** - njohjen e pasurive tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017);
- **Ndryshime në SNK 16 "Pronat Afatgjata Materiale" dhe SNK 38 "Pasuritë Jo-materiale"** - Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimi dhe amortizimi (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshime në SNK 16 "Pronat Afatgjata Materiale" dhe SNK 41 "Bujqësia"** - Bujqësi: Bujqësi: bartës të bimëve (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshime në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"**, - metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare individuale (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

Fondi ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. FKPK- MP parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

#### 3.1 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të ardhurat bruto përbëhen nga kthimet e instrumenteve financiare njohja dhe matja e të cilave është e shpalosur në politikat përkatëse të kontabilitetit të përfshira në këtë shënim, ku interesi nga depozitat bankare njihet në baza akruale.

Shpenzimet përbëhen nga tarifat të cilat përlllogariten në baza ditore të ngarkuara me normë specifike mbi bilancin bruto të mjeteve pensionale nga operacionet e FKPK-së.

#### 3.2 Kontributet

Kontributet e pranuar nga pjesëmarrësit llogariten në bazë akruale.

#### 3.3 Tërheqjet e kursimeve dhe refondimet

Tërheqjet e kursimeve, ose pagesat e benefiteve, të cilat u paguhen pjesëmarrësve ose pasardhësve të tyre, si dhe refondimet e kontributeve të gabuara, njihen në periudhën në të cilën njësitë përkatëse janë riblerë.

#### 3.4 Instrumentet financiare

Mjetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë investimet, paranë, ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat kontabël në lidhje me njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse kontabël të përfshira në këtë shënim. Instrumentet financiare janë të klasifikuara si mjete, detyrime ose ekuitete në përputhje me thelbin e aranzhimit kontraktual përkatës. Interesi, fitimi dhe humbjet në lidhje me instrumentet financiare të klasifikuara si mjete ose detyrime, raportohen si të hyra neto. Instrumentet financiare zbriten kur FKPK-MP ka të drejtën e ushtrueshme ligjore për të bërë zbritjen dhe ka për qëllim ujdinë, qoftë në bazë neto qoftë ta realizojë një mjet dhe njëkohësisht ta shlyejë detyrimin.

#### 3.5 Investimet

Të gjitha blerjet dhe shitjet e siguracioneve njihen në datën e tregtimit. Data e tregtimit është data kur FKPK-MP zotohet për blerjen ose shitjen e mjetit.

##### *Investimet e mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim përfaqësohen nga depozitat dhe investimet me pagesa fikse ose të paracaktuara si dhe me maturitet fikse të cilat FKPK-MP ka qëllimin pozitiv por edhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Depozitat me afat origjinal të maturimit prej tre muaj ose më pak klasifikohen si ekuivalentë të parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë, ndërsa ato me afat maturimi më të gjatë se tre muaj klasifikohen si investime të mbajtura deri në maturim.

Interesi për depozita përlllogaritet në baza akruale. Fletobligacionet e Qeverive ose Thesareve në kohën e përvetësimit vlerësohen sipas vlerave të tyre të diskontuara, ndërkohë që vlerësimet pasuese bëhen në vlerat e amortizuara të tyre.

##### *Investimet e disponueshme për shitje*

Mjetet e FKPK-MP të investuara në fondet e përbashkëta për investime të hapura janë të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Këto investime fillimisht njihen sipas kostos, që është vlera e drejtë e shumës së dhënë përfshirë kostot e blerjes që ndërlidhen me investimin.

Pas njohjes fillestare, investimet në fondet e përbashkëta për investime të hapura rivlerësohen sipas vlerës së drejtë duke u bazuar në çmimet e kuotuar në mbyllje të tregtimit në datën e raportimit.

##### *Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë paraqet shumën që do të pranohej me rastin e shitjes së një aseti ose shumën që do të duhej paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.5 Investimet (Vazhdim)

##### *Instrumentet financiare të matura sipas vlerës së drejtë*

Mjetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki i rëndit asetet dhe detyrimet financiare në tri nivele të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për mjete dhe detyrime identike;  
Niveli 2: shënimet e tjera hyrëse, mënjanë nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për observimin e mjeteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th. të bëra nga çmimet); dhe  
Niveli 3: shënimet hyrëse për mjetet dhe detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

Deri në datën e raportimit, instrumentet financiare të FKPK-MP të matura sipas vlerës së drejtë paraqiten si në vijim:

Klasa e investimeve	Niveli	Më	Më
		31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Instrumente për investime të hapura	1	1,084,732,950	1,023,619,618

Matjet e vlerës së drejtë të listuara sipër janë periodike. Nuk ka pasur lëvizje të mjeteve në mes të niveleve gjatë viteve që kanë përfunduar më 31 dhjetor 2015 dhe 2014.

##### *Dëmtimi*

Dëmtimi i investimeve njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ka rënie të përhershme të vlerës së tyre.

#### 3.6 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Për qëllime të rrjedhjes së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit prej tre ose më pak muajsh. Përfshirja bëjnë investimet në depozita bankare pa datë maturimi por me afat paralajmërimi dhe të cilat Bordi Drejtues nuk ka për qëllim t'i shesë, të cilat përjashtohen nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj.

#### 3.7 Tatimi

Mjetet pensionale të FKPK-së janë të liruara nga tatimi në fitim i korporatave.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.8 Menaxhimi i riskut financiar

Detyrimet ndaj pjesëmarrësve të FKPK-MP janë gjithmonë në vlerë të njëjtë me vlerën neto të mjeteve të pjesëmarrësve, **pra nuk ka hendek financimi për benefitet e ardhshme, për ç'arsye FKPK-MP nuk bën vlerësime aktuale.** Detyrimet e FKPK-MP nuk përbëhen nga asnjë instrument financiar, p.sh. mjete të huazuara nga institucione të tjera financiare, çfarë edhe e bën jo të nevojshëm menaxhimin e riskut për pjesën e detyrimeve të FKPK-MP.

Kur është në pyetje vlerësimi i riskut të instrumenteve financiare të cilat përbëjnë pjesën e mjeteve të FKPK-MP, pjesa dërrmuese e investimeve janë përmes instrumenteve për investime të hapura, që nënkupton se menaxhimi i riskut në baza ditore i është besuar menaxhuesve të këtyre instrumenteve. Si rezultat, mjetet financiare të FKPK-MP i ekspozohen drejtpërdrejt vetëm një numri të vogël risqesh (kryesisht riskut të çmimit) dhe atë vetëm me një pjesë të kufizuar të mjeteve, të cilat risqe Bordi Drejtues synon t'i menaxhojë përmes politikës së investimeve.

Politika e investimeve kërkon mbi të gjitha që mjetet e investuara, qoftë direkt ose indirekt, të jenë të diversifikuara mirë përgjatë emetuesve dhe klasave të asetëve, si dhe përgjatë qasjes investuese të instrumenteve për investime të hapura. Tutje, si mënyrë për menaxhim të risqeve direkte, politika vendos kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në instrumente të klasave të caktuara të asetëve (me vetëm aksione: 57%; me klasa mikse të asetëve: 35%; me vetëm fletobligacione duke përfshirë obligacionet e Thesarit të Kosovës: 34%; dhe tregje të parasë dhe bonot e Thesarit të Kosovës: 10%); si dhe kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në instrumente me qasje të caktuar investuese (me Kthim drejtimor/Kthim pa përshtatje për risk: 60%; me Target risku/Menaxhim risku/Kthim absolut: 46%; dhe me të ardhura: 23%). Në përputhje me këtë kornizë Bordi Drejtues merr vendime të rrisë ose zvogëlojë ekspozimin ndaj një instrumenti të caktuar për investime të hapura varësisht nga performanca dhe plasmanet e instrumentit, ose korrelacionit të tij me instrumentet e tjera, si dhe bindjet për perspektivën afatshkurtër dhe afatmesme për klasën e asetëve dhe qasjen investuese të instrumentit në fjalë. FKPK-ja nuk aranzhon kontrata në avancë (*forwards*), shkëmbime (*swaps*) ose derivate të tjera (*derivatives*) për të menaxhuar dhe kontrolluar këto risqe për mjetet e FKPK-MP.

Departamenti i financave i FKPK-së çdo tre muaj analizon pajtueshmërinë e investimeve direkte, por edhe investimeve indirekte, përmes portofoliovë të instrumenteve për investime të hapura, me politikat investuese të FKPK-së. Risku dhe luhatshmëria e investimeve direkte dhe indirekte po ashtu vlerësohet çdo tre muaj. Të gjeturat shqyrtohen nga Komisioni i investimeve i Bordit Drejtues të FKPK-së, dhe shërbejnë si ndihmë në vendimmarrje për investimet.

Në vijim prezantohen risqet kryesore të cilave direkt iu ekspozoheshin asetet e FKPK-MP në datën e raportimit:

##### 3.8.1 Risku valutor

Në datën e raportimit plasmanet në fletobligacionet e Thesarit të Kosovës si dhe afatizimet në banka ishin të gjitha në valutën euro. Si mjet për menaxhimin e riskut valutor në instrumentet për investime të hapura, politika e investimeve e FKPK lejon që maksimumi 10% e mjeteve të FKPK-MP të jenë të investuara në instrumente jo të denominuara në euro ose me mbrojtje për euro.

Instrumentet për investime të hapura në të cilat FKPK-ja kishte investime në datën e raportimit ishin të gjitha të denominuara në euro ose me mbrojtje për euro; ku menaxhuesit e këtyre instrumenteve përdorin derivate të valutës për të menaxhuar dhe kontrolluar riskun valutor.

Meqë nuk ka patur ekspozim direkt ndaj riskut valutor në datën e raportimit, nuk janë bërë analiza sensitiviteti në efektin e ndryshimeve të valutës në të ardhurat gjithëpërfshirëse për fund vitin më 31 dhjetor, 2014 dhe 2015.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### 3.8.2 Risku i normës së interesit

Risku i normave të interesit është risku që vlera reale e rrjedhave të ardhshme të parasë nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Në datën e raportimit FKPK-MP kishte investime direkte në instrumente që mbahen deri në maturim të cilat kishin normë fikse të interesit, ndërkaq nuk kishte investime direkte në instrumente financiare me normë variabile të interesit.

	Më 31 dhjetor 2015		Më 31 dhjetor 2014	
	Mjetet	Detyrimet	Mjetet	Detyrimet
	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Normë fikse</b>				
Investimet që mbahen deri në maturim	95,654,197	-	54,701,478	-
<b>Gjithsej</b>	<b>95,654,197</b>	<b>-</b>	<b>54,701,478</b>	<b>-</b>

##### 3.8.3 Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e parave të gatshme të mjaftueshme, disponueshmërinë e fondeve nëpërmjet instrumenteve adekuate kreditore dhe aftësinë për arkëtim në kohë - brenda afateve të përcaktuara - të shumave të arkëtueshme nga palët e treta.

Mesatarja mujore e riblerjeve nga FKPK-MP përmes tërheqjeve të kursimeve dhe refondimeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 1,640,183 euro (2014: 1,189,903 euro). Kontributet mesatare mujore të arkëtuara për vitin, në shumën prej 11,459,968 euro (2014: 10,738,578 euro), vazhduan të jenë dukshëm më të larta sesa të dalurat mujore.

Të gjitha investimet përmes instrumenteve për investime të hapura mund të shpengohen brenda 1 deri 10 ditëve, dhe të gjitha investimet e mjeteve të FKPK-MP-së në instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës dhe afatizimet bankare kanë një afat origjinal të maturimit prej më pak se pesë vjetëve.

Tabela e mëposhtme paraqet maturimet kontraktuale të mbetura të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FKPK-MP.

	Më 31 dhjetor 2015		Më 31 dhjetor 2014	
	Afatshkurtër Deri 1 vit	Afatmesëm 1-5 vjet	Afatshkurtër Deri 1 vit	Afatmesëm 1-5 vjet
	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Mjetet financiare</b>				
Paraja në bankë	50,906,018	-	9,938,218	-
Investimet e mbajtura deri në maturim	55,999,981	39,654,216	34,123,521	20,577,957
Kontributet e arkëtueshme	8,758,404	-	7,984,158	-
	<b>115,664,403</b>	<b>39,654,216</b>	<b>52,045,897</b>	<b>20,577,957</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogaritë e pagueshme	1,959,837	-	498,716	-
	<b>1,959,837</b>	<b>-</b>	<b>498,716</b>	<b>-</b>
<b>Hendeku i maturimit</b>	<b>113,704,566</b>	<b>39,654,216</b>	<b>51,547,181</b>	<b>20,577,957</b>

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### 3.8.4 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPK-MP nëse një klient ose palë tjetër nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale. Asetet e FKPK-MP i janë ekspozuar direkt vetëm instrumenteve të borxhit të Thesarit të Kosovës, të cilat ende mbesin pa rejting; megjithatë, sikurse Ligji në fuqi, që i klasifikon instrumentet e borxhit publik në kategorinë e klasit të parë, edhe FKPK-MP bën të njejtën gjë në analizën e ekspozimit direkt dhe indirekt në portofolet e instrumenteve për investime të hapura, të ekspozuara ndaj riskut kreditor.

FKPK-MP e konsideron riskun kreditor si shumë të ulët për investimet e FKPK-MP duke pasur parasysh diversifikimin shumë të madh në emetues të ndryshëm, si dhe vlerësimin e instrumenteve të borxhit në përbërjen e instrumenteve për investime të hapura.

Në vijim është paraqitur rejtingu i investimeve direkte, dhe indirekte përmes instrumenteve për investime të hapura, të mjeteve të FKPK-MP më 31 dhjetor 2015.

Përshkrimi	Vlerësimet përkatëse	Përqindja e mjeteve të FKPK-së
Të klasit të parë	AAA	17.9%
E lartë	AA+ , AA, AA-	10.4%
Mesatare e lartë	A+ , A, A-	3.2%
Mesatare e ulët	BBB+ , BBB, BBB-	2.5%
Spekulative	BB+ , BB, BB-	0.8%
Më spekulative	B+ , B, B-	0.4%
Rrezik substancial	CCC+	-
Jashtëzakonisht spekulative	CCC	-
Në mospagesë, me pak gjasa për kthim	CCC- , CC, C	0.0%
Në mospagesë	D	0.0%
<b>Gjithsej</b>		<b>35.2%</b>

##### 3.8.5 Risku i çmimit

Përkundër uljes së moderuar të ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të vlerës së drejtë të instrumenteve për investime të hapura, risku i çmimit vazhdon të jetë faktori më i rëndësishëm i riskut direkt ndaj aseteve të investuara të FKPK-MP. FKPK-MP përmes politikës së investimeve tenton të menaxhojë këtë risk duke i shpërndarë investimet në instrumente për investime të hapura pa korreleacion me njëra-tjetër, e që në portofolet e tyre investuese kanë klasa të ndryshme të instrumenteve financiare si dhe qasje dhe objektiva të ndryshme investuese.

###### *Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të çmimit të investimeve në instrumente të hapura*

Sikur çmimet e instrumenteve për investime të hapura të ishin 5% më të larta/ulëta në datën e raportimit, atëherë mjetet neto të pjesëmarrësve do të rriteshin me 66,532,108 euro, ose do të uleshin me 66,532,109 euro (2014 respektivisht: do të rriteshin me 51,186,216 euro ose do të uleshin me 51,175,746 euro).

###### *Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të çmimit të aksioneve në kuadër të instrumenteve të hapura*

Vlera e drejtë e aksioneve në portofolet e instrumenteve për investime të hapura në ishte 749,998,176 euro, ose 66.7% e mjeteve të FKPK-MP (2014: 725,587,238 euro, ose 66.7%). Risku i çmimit të aksioneve në portofolet e instrumenteve për investime të hapura është shumë më i ulët se risku direkt i çmimeve të vet instrumenteve për investime të hapura, pasi që ndikimi në datën e raportimit i rritjes/uljes prej 5% në çmimin e aksioneve në këto investime indirekte do të bënte që mjetet neto të pjesëmarrësve respektivisht: të rriten me 37,504,629 euro ose të bien me 37,495,189 euro (2014 respektivisht: të rriteshin me 36,279,889 euro ose të uleshin me 36,278,835 euro).

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### 3.8.6 Ekspozimi përmes investimeve indirekte

Pjesa më e madhe e mjeteve të FKPK-MP janë të investuara përmes instrumenteve për investime të hapura të cilat tregtojnë me klasa të ndryshme të asetëve dhe përdorin politika të ndryshme të investimit dhe riskut. Si rezultat, mjetet e FKPK-MP i ekspozohen risqeve të ndryshme për investimet indirekte varësisht nga mjetet e investuara në një instrument për investime të hapura. Kur të gjitha investimet, direkte dhe indirekte, merren parasysh, ekspozimi i mjeteve të FKPK-MP më 31 dhjetor 2015 ishte si në vijim:

*Valutat* - USD: 56.0%; EUR: 27.0%; GBP: 7.9%; JPY: 1.6%; AUD: 1.9%; DKK: 1.6%; CAD: 1.4%; CHF: 1.2%; Other: 1.4%.

*Klasa e asetëve* - Aksione: 60.9%; Borxh thesaresh: 23.2%; Borxh korporatash: 12.0%; Para e gatshme: 6.4%; Derivate neto: -2.5%.

Risqet kryesore ndaj të cilat ekspozoheshin vetë instrumentet për investime të hapura më 31 dhjetor 2015 ishin:

Instrumenti	Risqet kryesore
Vanguard - GSIF	Risku i çmimit; Risku shtetëror/politik; Risku i ndjekjes së indeksit.
AXA - GILB	Risku kreditor; Risku i palës tjetër; Risku i normave të interesit.
BNY Mellon - RRF	Risku i çmimit; Risku kreditor; Risku i palës tjetër; Risku i normave të interesit dhe ai valutor.
Tobam - ABWEF	Risku i çmimit; Risku i palës tjetër; Risku valutor; Risku i menaxhimit.
Schroders - SISF	Risku kreditor; Risku i palës tjetër; Risku valutor; Risku i derivateve.
Nordea 1 - GSEF	Risku i çmimit; Risku i palës tjetër; Risku shtetëror/politik.
Nordea 1 - SRF	Risku i çmimit; Risku kreditor; Risku i palës tjetër; Risku shtetëror/politik; Risku i derivateve.
KBI - IDPDEF	Risku i çmimit; Risku i palës tjetër; Risku i likuiditetit; Risku valutor.
AXA - WFOI	Risku kreditor; Risku i palës tjetër.
Pictet - HDS	Risku i çmimit; Risku i palës tjetër; Risku valutor; Risku shtetëror/politik.

Lista e plotë e risqeve që iu ekspozohen instrumentet mund të gjindet në prospektusin përkatës të secilit instrument.

#### 3.9 Vlerësimet dhe gjykimet e konsiderueshme

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të mjeteve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme që mund të ndikohen. Informacionet mbi sferat materiale me pasiguri të madhe të vlerësimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në vijim:

##### *Lejesa për zhvlerësimin e investimeve të disponueshme për shitje*

FKPK-MP përcakton se investimet e disponueshme për shitje zhvlerësohen kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim i asaj që është e konsiderueshme ose e zgjatur kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, FKPK-MP vlerëson ndër faktorët e tjerë, luhatshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm kur ka prova të përkeqësimit në shëndetin financiar të investitorëve, të industrisë dhe të sektorit e performancës, ndryshimeve në teknologji, dhe rrjedhën e parave operative dhe të financimit.



#### 4 PARAJA NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës	50,906,018	9,938,218
<b>Gjithsej paraja në bankë</b>	<b>50,906,018</b>	<b>9,938,218</b>

Gjatë 2014 dhe 2015 nuk është ofruar interes për llogarinë rrjedhëse të FKPK-MP në Bankën Qendrore të Kosovës.

#### 5 KONTRIBUTET E ARKËTUESHME

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Kontributet e arkëtueshme	8,758,404	7,984,158
<b>Gjithsej kontributet e arkëtueshme</b>	<b>8,758,404</b>	<b>7,984,158</b>

Kontributet e arkëtueshme kanë të bëjnë me kontributet e pranuar në llogarinë rrjedhëse në BQK deri më datën 18 të muajit vijues (2014: deri më datën 18) dhe të cilat nuk janë shndërruar në aksione në datën e raportimit.

#### 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Vanguard - GSIF	6.1	348,579,355	343,025,434
BNY Mellon - RRF	6.2	170,643,379	166,159,683
AXA - GILB	6.3	95,816,363	71,926,649
Schroders - SISF	6.4	111,573,428	114,516,911
Aquila - RP7	6.5	-	28,803,675
Nordea 1 - GSEF	6.6	57,695,077	50,304,385
Nordea 1 - SRF	6.7	145,649,845	100,812,922
KBI - IDPDEF	6.8	58,909,446	54,922,848
AXA - WFOI	6.9	27,877,091	26,287,722
Pictet - HDS	6.10	32,956,868	30,197,501
Tobam - ABWEF	6.11	35,032,098	36,661,888
<b>Gjithsej investimet e disponueshme për shitje</b>		<b>1,084,732,950</b>	<b>1,023,619,618</b>

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.1 Vanguard Investment Series plc - Global Stock Index Fund Euro hedged (ISIN: IE00B03HD316)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>22,705,338</b>	<b>343,025,434</b>	<b>22,678,696</b>	<b>313,444,532</b>
Riinvestimi i rabateve	27,110	423,931	26,642	383,016
Rivlerësimi - Rritja	-	6,014,502	-	30,011,423
Tarifat e ngarkuara	-	(884,512)	-	(813,537)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>22,732,448</b>	<b>348,579,355</b>	<b>22,705,338</b>	<b>343,025,434</b>

Ky fond kërkon të sigurojë rritjen afatgjate të kapitalit duke ndjekur performancën e Morgan Stanley Capital International (MSCI) World Free Index (indeksi), indeks ky i peshuar dhe bazuar në madhësinë e kapitalit të kompanive në vendet e zhvilluara. Politika e investimeve e Global Stock Index Fund është që kryesisht të investohet në aksione të zakonshme. Investimet e FPKK-së në këtë fond blejnë aksione sipas Vlerës Neto të Mjeteve (VNM) për aksion në ditën relevante të afarizmit. Ky fond nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM. Kthimi neto për fundvitin 31 dhjetor 2015 ishte 1.50% (2014: 9.31%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë me normë vjetore prej 0.25% (2014: 0.25%) të mjeteve. Fondi po ashtu ofron rabat prej 0.12% në tarifën menaxhuese (2014: 0.12%) e cila riinvestohet në muajin pasardhës, gjë e cila bën që tarifa neto menaxhuese që ngarkon fondi të jetë 0.13% (2014: 0.13%) e mjeteve në vit. Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

### 6.2 BNY Mellon - Real Return Fund (ISIN IE00B504KX99)

	2015		2014s	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>138,385,677</b>	<b>166,159,683</b>	<b>117,521,047</b>	<b>133,139,594</b>
Investimet e reja gjatë vitit	-	-	20,864,630	25,000,000
Rivlerësimi - Rritja	-	4,483,696	-	8,020,089
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>138,385,677</b>	<b>170,643,379</b>	<b>138,385,677</b>	<b>166,159,683</b>

BNY Mellon Real Return Fund është instrument i kthimit absolut i cili i investon mjetet pjesërisht në para, fletobligacione dhe pjesërisht në aksione. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet dhe interesat reflektohen në VNM-në e fondit. Kthimi vjetor për fundvitin 31 dhjetor 2015 ishte 2.70% (2014: 5.98%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë sipas normës vjetore prej 0.60% të mjeteve me fondin dhe paguhet ndaras nëpërmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Gjithsej tarifat që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fund vitin 31 dhjetor 2015 kapin shumën prej 1,033,227 euro (2014: 868,854 euro). Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.3 AXA - Global Inflation Linked Bonds Eur (ISIN LU0227145629)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>497,762</b>	<b>71,926,649</b>	<b>433,540</b>	<b>57,478,701</b>
Investimet e reja gjatë vitit	169,976	25,000,000	63,995	9,200,000
Riinvestimi i rabateve	298	43,585	227	31,648
Rivlerësimi - Rritja / (Rënia)	-	(796,761)	-	5,462,474
Tarifat e ngarkuara	-	(357,110)	-	(246,174)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>668,036</b>	<b>95,816,363</b>	<b>497,762</b>	<b>71,926,649</b>

AXA Global Inflation Linked Bonds është një instrument i kthimit absolut që pjesën dërrmuese të mjeteve i investon në bono të mbrojtura nga inflacioni të emetuara nga shtetet sovraane dhe korporatat. Fondi nuk paguan dividend, kështu që të gjitha përfitimet dhe interesat reflektohen në VNM. Kthimi vjetor neto për fundvitin 31 dhjetor 2015 ishte -0.74% (2014: 8.99%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet çdo ditë me një normë vjetore prej 0.40% (2014: 0.40%) të mjeteve me fondin; mirëpo, kur vlera e mjeteve është më e lartë se 50 milionë euro, ofrohet rabati në normë vjetore prej 5% të mjeteve me fondin i cili përllogaritet në baza ditore dhe riinvestohet në muajin e ardhshëm, duke bërë kështu që tarifa neto menaxhuese të jetë 0.35% e mjeteve në vit. Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

### 6.4 Schroders - International Strategic Bond Euro Hedged (ISIN LU0201524265)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>734,036</b>	<b>114,516,911</b>	<b>639,039</b>	<b>96,379,844</b>
Investimet e reja gjatë vitit	-	-	94,997	15,000,000
Rivlerësimi - Rritja / (Rënia)	-	(2,943,483)	-	3,137,067
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>734,036</b>	<b>111,573,428</b>	<b>734,036</b>	<b>114,516,911</b>

Schroders International Strategic Bond është fond i përbashkët me seli në Luksemburg i cili operon përmes investimeve në bono dhe instrumente të tjera financiare me kthim fiks dhe variabil të denominuara në valuta të ndryshme që emetohen nga qeveritë, agjencitë qeveritare, agjencitë mbikombëtare dhe korporatat gjithandëj nëpër botë. Fondi nuk paguan dividend, kështu që të gjitha të ardhurat reflektohen në çmimin ofertues të fondit. Kthimi vjetor për fundvitin 31 dhjetor 2015 ishte -2.57% (2014: 3.44%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në fund të çdo tremujori me normë vjetore prej 0.50% të mjeteve (2014: 0.50%), dhe paguhet veçmas përmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Megjithatë, për vlerat e mjeteve me fondin më të larta se 100 milionë euro, norma vjetore e tarifës reduktohet në 0.45% të aseteve. Gjithsej tarifaf që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fundvitin 31 dhjetor 2015 kapin shumën prej 558,529 euro (2014: 508,375 euro). Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.5 Aquila - AC Risk Parity 7 Fund (ISIN LU0554703917)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>266,152</b>	<b>28,803,675</b>	<b>266,152</b>	<b>26,986,630</b>
Rivlerësimi - Rritja	-	44,541	-	1,817,045
Tërheqjet gjatë vitit	(266,152)	(28,848,216)	-	-
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>266,152</b>	<b>28,803,675</b>

Aquila - AC Risk Parity 7 Fund i Alceda Fund Management është një instrument i kthimit absolut që pjesën dërrmuese të mjeteve i investon në fletobligacione me rejting shumë të lartë, ndërkaq pjesën tjetër në kontrata në avans të indekseve të fletobligacioneve dhe aksioneve për qëllime të mbrojtjes nga risqet. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet dhe interesat reflektohen në VNM-në e fondit. Tarifa e menaxhimit kalkulohej çdo ditë sipas normës vjetore prej: 1.06% të mjeteve kur shumat e investuara janë nën 50,000,000 euro; 0.96% të mjeteve kur shumat e investuara ishin në mes të 50,000,000 euro dhe 79,999,999 euro; 0.79% të mjeteve kur shumat e investuara ishin në mes të 80,000,000 euro dhe 99,999,999 euro, sikurse edhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. Tarifat janë paguar ndarazi nëpërmes faturës, që d.m.th. se nuk e kanë reduktuar VNM-në. Gjithsej tarifrat që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fundvitin 31 dhjetor 2015 kapin shumën prej 143,518 euro (2012: 231,565 euro). Në qershor 2015 Bordi Drejtues tërhoqi të gjitha investimet e mbetura në këtë fond, me ç'rast edhe u realizuan fitimet prej 1,479,231 euro.

### 6.6 Nordea 1 – Global Stable Equity Fund (ISIN LU0257969260)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>2,648,993</b>	<b>50,304,385</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Investimet e reja gjatë vitit	-	-	2,648,993	45,000,000
Rivlerësimi - Rritja	-	7,390,692	-	5,304,385
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>2,648,993</b>	<b>57,695,077</b>	<b>2,648,993</b>	<b>50,304,385</b>

Nordea 1 - Global Stable Equity Fund është një fond aktiv që kryesisht përmban aksione të korporatave globale me kthime, dividendat dhe qarkullime të parasë stabile. **Megjithatë, fondi mund t'i mbajë deri në 1/3 e mjeteve në para të gatshme ose t'i investojë ato në bono ose në instrumente të tjera të borxhit me qëllim të menaxhimit të riskut. Fondi nuk paguan dividend andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Kthimi vjetor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 14.69% (11 qershor – 31 dhjetor 2014: 16.15%). Tarifa e menaxhimit kalkulohej në baza ditore me një normë vjetore prej: 0.43% të mjeteve dhe paguhet përmes faturës, d.m.th. nuk e redukon VNM-në. Shuma e përgjithshme e tarifave të ngarkuara nga menaxheri i fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 241,760 euro (2014: 81,464 euro). Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.**

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.7 Nordea 1 –Stable Return Fund X EUR (ISIN LU0539147214)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>6,124,722</b>	<b>100,812,922</b>	-	-
Investimet e reja gjatë vitit	2,343,292	40,000,000	6,124,722	96,000,000
Rivlerësimi - Rritja	-	4,836,923	-	4,812,922
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>8,468,014</b>	<b>145,649,845</b>	<b>6,124,722</b>	<b>100,812,922</b>

Nordea 1 - Stable Return Fund është një fond aktiv që përmban aksione dhe fletobligacione të korporatave globale dhe letra me vlerë të qeverive, dhe synon të gjenerojë kthim nga të dyja klasat e mjeteve duke menaxhuar në të njëjtën kohë risqet përmes përdorimit strategjik të derivateve financiare. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Kthimi vjetor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 4.50% (11 qershor - 31 dhjetor 2014: 7.09%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në baza ditore me një normë vjetore prej: 0.56% të mjeteve dhe paguhet përmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Shuma e përgjithshme e tarifave të ngarkuara nga menaxhuesi i fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 676,803 euro (2014: 232,940 euro). Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

### 6.8 Kleinwort Benson Investors - Institutional Developed Equity Fund H (ISIN IE00B589V552)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>3,868,079</b>	<b>54,922,848</b>	-	-
Investimet e reja gjatë vitit	-	-	3,868,079	51,000,000
Riinvestimi i rabateve	924	14,367	-	-
Rivlerësimi - Rritja	-	4,403,728	-	4,075,341
Tarifat e ngarkuara	-	(431,497)	-	(152,493)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>3,869,003</b>	<b>58,909,446</b>	<b>3,868,079</b>	<b>54,922,848</b>

Kleinwort Benson Investors – Institutional Developed Equity Fund, që e ndryshoi emrin gjatë 2015-s nga Kleinwort Benson Investors – Institutional Dividend Plus Developed Equity Fund, është një fond aktiv që përmban aksione me dividend të qëndrueshëm të korporatave të vendeve të zhvilluara. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Kthimi vjetor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 7.23% (3 korrik - 31 dhjetor 2014: 8.77%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në baza ditore me një normë vjetore prej 0.73% të mjeteve dhe ndalet nga fondit, d.m.th. e redukton VNM-në (2014: 0.73%). Me fillim nga 1 janari 2015, për vlerat e mjeteve mbi 40 milionë euro fondi ofron 0.1% vjetore të vlerës së mjeteve si rabat në tarifën menaxhuese. Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.9 AXA - Optimal Income I EUR (ISIN: LU0184635471)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>209,664</b>	<b>26,287,722</b>	-	-
Investimet e reja gjatë vitit	49	6,667	209,664	26,000,000
Rivlerësimi - Rritja	-	1,737,267	-	348,852
Tarifat e ngarkuara	-	(154,565)	-	(61,130)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>209,713</b>	<b>27,877,091</b>	<b>209,664</b>	<b>26,287,722</b>

AXA - Optimal Income Fund është një fond aktiv që përmban aksione dhe fletobligacione të korporatave dhe letra me vlerë të qeverive, kryesisht nga Evropa, i cili ka për qëllim të gjenerojë një kthim absolut në planin afatgjatë nga të dyja këto klasa të instrumenteve financiare. Me qëllim të menaxhimit të riskut, përdorimi në shkallë të vogël i derivateve është i lejuar. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Kthimi vjetor neto për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 6.02% (11 korrik – 31 dhjetor 2014: 1.24%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në baza ditore me një normë vjetore prej: 0.55% të mjeteve (2014: 0.55%) dhe ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

### 6.10 Pictet - High Dividend Selection - Z Euro (ISIN: LU0650147423)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>202,003</b>	<b>30,197,501</b>	-	-
Investimet e reja gjatë vitit	-	-	202,003	30,000,000
Rivlerësimi - Rritja	-	2,759,367	-	197,501
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>202,003</b>	<b>32,956,868</b>	<b>202,003</b>	<b>30,197,501</b>

Pictet – High Dividend Selection Fund është një fond aktiv që kryesisht përmban aksione të korporatave globale me dividend stabil. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Kthimi vjetor neto për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 9.14% (14 korrik – 31 dhjetor 2014: 1.88%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në baza ditore me një normë vjetore prej: 0.63% të mjeteve dhe paguhet përmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Shuma e përgjithshme e tarifave të ngarkuara nga menaxheri i fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 209,272 euro (2014: 76,744 euro). Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.11 Tobam - Anti-benchmark World Equity Fund Euro-Hedged (ISIN: LU1067857836)

	2015		2014	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>2,493</b>	<b>36,661,888</b>	-	-
Investimet e reja gjatë vitit	6	103,472	2,493	35,000,000
Rivlerësimi - Rritja / (Zvogëlimi)	-	(1,217,672)	-	1,748,152
Tarifat e ngarkuara	-	(515,590)	-	(86,264)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>2,499</b>	<b>35,032,098</b>	<b>2,493</b>	<b>36,661,888</b>

Tobam – Anti-benchmark World Equity Fund është një fond aktiv që përzgjedh aksione të korporatave globale me qëllim të arritjes së shkallës optimale të diversifikimit. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Kthimi vjetor neto për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte -4.70% (16 korrik – 31 dhjetor 2014: 4.50%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore me një normë vjetore prej: 1.40% të mjeteve, nga e cila 0.80% kthehet në formë të rabatit (2014: 0.60% e mjeteve dhe pa rabat), e cila ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Gjatë 2015-s nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

### 6.12 Tarifat dhe rabatet e instrumenteve për investime të hapura

		Për fundvitin 31 dhjetor 2015			Për fundvitin 31 dhjetor 2014		
		Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto	Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard – GSIF	6.1	884,512	(424,566)	459,946	813,537	(390,498)	423,039
BNY Mellon – RRF	6.2	1,033,227	-	1,033,227	868,854	-	868,854
AXA – GILB	6.3	357,110	(44,635)	312,475	246,174	(30,762)	215,412
Schroders – SISF	6.4	558,529	-	558,529	508,375	-	508,375
Aquila – RP7	6.5	143,518	-	143,518	231,565	-	231,565
Nordea 1 - GSEF	6.6	241,760	-	241,760	81,464	-	81,464
Nordea 1 - SRF	6.7	676,803	-	676,803	232,940	-	232,940
KBI - IDPDEF	6.8	431,497	(19,186)	412,311	152,493	-	152,493
AXA - WFOI	6.9	154,565	-	154,565	61,130	-	61,130
Pictet - HDS	6.10	209,272	-	209,272	76,744	-	76,744
Tobam - ABWEF	6.11	515,590	(294,248)	221,342	86,264	-	86,264
ECM – DEC		-	-	-	101,033	-	101,033
<b>Gjithsej tarifa e rabate</b>		<b>5,206,383</b>	<b>(782,635)</b>	<b>4,423,748</b>	<b>3,460,573</b>	<b>(421,260)</b>	<b>3,039,313</b>

<sup>1</sup> Gjatë 2014 FKPK-ja e ka tërhequr në tërësi investimin në instrumentin e fondit të ECM- DEC.

## 7 INVESTIMET QË MBAHEN DERI NË MATURIM

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Banka Kombëtare Tregtare – Dega Kosovë	7.1	3,009,082	-
Banka për Biznes	7.2	3,008,014	-
Fletobligacionet e Thesarit të Kosovës	7.3	89,637,101	54,701,478
<b>Gjithsej investimet që mbahen deri në maturim</b>		<b>95,654,197</b>	<b>54,701,478</b>

Në datën e raportimit vlera e afatizimeve me bankat komerciale vendore ishte 6,017,096 euro (2014: zero euro). Gjithsej interesi i akumuluar nga afatizimet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 ishte 17,096 euro (2014: zero euro).

### 7.1 Banka Kombëtare Tregtare – Dega Kosovë

	2015	2014	
		EUR	EUR
<b>Më 1 janar</b>	-	-	
Plasmanet e reja	3,000,000	-	
Interesi i akumuluar	9,082	-	
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>3,009,082</b>	<b>-</b>	

Më 28 tetor 2015 FPKP-MP plasoi 3,000,000 euro në afatizim bankar me Banka Kombëtare Tregtare – Dega Kosovë, me një normë interesi prej 1.7% dhe afat origjinal të maturimit prej një viti.

### 7.2 Banka për Biznes

	2015	2014	
		EUR	EUR
<b>Më 1 janar</b>	-	-	
Plasmanet e reja	3,000,000	-	
Interesi i akumuluar	8,014	-	
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>3,008,014</b>	<b>-</b>	

Më 28 tetor 2015 FPKP-MP plasoi 3,000,000 euro në afatizim bankar me Banka për Biznes – bankë komerciale që vepron në Republikën e Kosovës - me një normë interesi prej 1.5% dhe afat origjinal të maturimit prej një viti.



## 7 INVESTIMET QË MBAHEN DERI NË MATURIM (VAZHDIM)

### 7.3 Fletobligacionet e Thesarit të Kosovës

					2015	
ISIN   Kuponi   Maturiteti	Më 1 janar	Plasmanet e reja	Interesi i akumuluar	Maturuar / Kuponët	Më 31 dhjetor	
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	
KV1104340433   1.34   22.04.2015	12,449,874	-	50,126	(12,500,000)	-	
KV1104540457   1.40   17.06.2015	9,339,215	-	60,785	(9,400,000)	-	
KV1204610466   2.60   30.06.2016	6,009,295	-	149,976	(156,000)	6,003,271	
KV1104940495   2.10   19.08.2015	12,334,432	-	165,568	(12,500,000)	-	
KV1205110510   2.90   30.09.2016	7,050,916	-	202,928	(203,000)	7,050,844	
KV1205510558   2.90   01.12.2016	7,517,746	-	217,199	(217,500)	7,517,445	
KV1105820589   2.00   22.07.2015	-	9,513,805	96,195	(9,610,000)	-	
KV1105940594   2.00   10.02.2016	-	9,801,786	175,689	-	9,977,475	
KV1206110619   2.80   31.03.2017	-	347,979	8,110	(4,900)	351,189	
KV1106440648   1.50   18.05.2016	-	9,850,599	92,084	-	9,942,683	
KV1206520656   3.20   29.05.2018	-	6,992,487	134,186	(114,415)	7,012,258	
KV1206710671   2.80   30.06.2017	-	10,000,956	140,955	(140,955)	10,000,956	
KV1207130716   4.90   31.08.2020	-	4,208,024	76,932	-	4,284,956	
KV1207210725   2.80   30.09.2017	-	10,000,000	70,235	-	10,070,235	
KV1107420749   1.60   20.04.2016	-	4,404,374	13,864	-	4,418,238	
KV1107540754   1.60   07.12.2016	-	5,068,011	4,918	-	5,072,929	
KV1207610763   2.60   31.12.2017	-	7,934,622	-	-	7,934,622	
	<b>54,701,478</b>	<b>78,122,643</b>	<b>1,659,750</b>	<b>(44,846,770)</b>	<b>89,637,101</b>	

					2014	
ISIN   Kuponi   Maturiteti	Më 1 janar	Plasmanet e reja	Interesi i akumuluar	Maturuar / Kuponët	Më 31 dhjetor	
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	
KV1102140211   2.26   23.04.2015	11,727,484	-	82,516	(11,810,000)	-	
KV1102820282   1.49   19.02.2015	9,979,422	-	20,578	(10,000,000)	-	
KV1103020305   1.24   19.03.2015	1,725,390	-	4,610	(1,730,000)	-	
KV1103240327   1.98   22.10.2015	14,760,760	-	239,240	(15,000,000)	-	
KV1103420343   1.20   21.05.2015	14,929,849	-	70,151	(15,000,000)	-	
KV1103720374   1.09   23.07.2015	-	17,791,846	98,154	(17,890,000)	-	
KV1103920398   0.92   20.08.2015	-	3,364,309	15,691	(3,380,000)	-	
KV1104340433   1.34   22.04.2016	-	12,337,826	112,048	-	12,449,874	
KV1104540457   1.40   17.06.2016	-	9,268,795	70,420	-	9,339,215	
KV1204610466   2.60   30.06.2016	-	6,011,634	75,661	(78,000)	6,009,295	
KV1104940495   2.10   19.08.2016	-	12,240,102	94,330	-	12,334,432	
KV1205110510   2.90   30.09.2016	-	7,000,000	50,916	-	7,050,916	
KV1205510558   2.90   01.12.2016	-	7,500,000	17,746	-	7,517,746	
	<b>53,122,905</b>	<b>75,514,512</b>	<b>952,061</b>	<b>(74,888,000)</b>	<b>54,701,478</b>	

Fletobligacionet e Thesarit të Kosovës nuk kanë rejting. Është qëllimi i Bordit Drejtues t'i mbajë deri në maturitet të gjitha investimet e FKPK-MP në këto instrumente.

## 8 DETYRIMET NDAJ FKPK-O

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve dhe rabatet - të pagueshme	276,599	319,203
Diferenca nga refundimet e kontributeve të gabuara - të pagueshme	451	47,622
<b>Gjithsej detyrimet ndaj FKPK-O</b>	<b>277,050</b>	<b>366,825</b>

Më 31 dhjetor 2015 bilanci i tarifës së pagueshme në vlerë prej 276,599 euro ka të bëjë me tarifën e FKPK-së të ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve (237,612 euro), dhe rabatet e riinvestuara të pagueshme (38,987 euro), të cilat nuk u transferuan tek FKPK-O deri në datën e raportimit (31 dhjetor 2014: 319,203 euro, të gjitha të ndërlidhura me tarifën).

Kur një kontribut pensional dëshmohet se është arkëtuar gabimisht, vlera nominale i refundohet paguesit. Sipas politikave të FKPK-së në fuqi ndryshimet në mes të vlerës së refunduar dhe vlerës së aksioneve të riblera në ditën e refundimit, trajtohen si të hyra të tjera (ose shpenzime të tjera) për FKPK-O. Më 31 dhjetor 2015 bilanci i diferencave nga refundimet të pagueshme ishte 451 euro (31 dhjetor 2014: 47,622 euro).

## 9 DETYRIMET PËR AKSIONET E RIBLERA

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Detyrimet për refundime	154,176	118,203
Detyrimet për tërheqje të kursimeve	1,512,582	-
<b>Gjithsej detyrime për aksionet e riblera</b>	<b>1,666,758</b>	<b>118,203</b>

Më 31 dhjetor 2015 bilanci i mjeteve pensionale të pagueshme për shkak të refundimeve dhe të tërheqjeve të kursimeve (pagesave të benefiteve) të cilat nuk ishin transferuar tek përfituesit përkatës deri në datën e raportimit ishte 1,666,758 euro (2014: 118,203 euro).

## 10 JO-KONTRIBUTET

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Jo-kontributet	16,029	13,688
<b>Gjithsej jo-kontributet</b>	<b>16,029</b>	<b>13,688</b>

Transferet hyrëse në llogarinë e FKPK-së në BQK për grumbullimin e mjeteve, të cilat në momentin e procesimit të ekstraktit bankar identifikohen si arkëtime të gabuara dhe nuk janë kontribute pensionale, klasifikohen si jo-kontribute dhe për to nuk emetohen aksione. Në të gjitha rastet e tjera për transferet hyrëse të kontributeve fillimisht emetohen aksione, e nëse dëshmohet të kenë qenë arkëtime të gabuara refundohen. Më 31 dhjetor 2015 bilanci i jo-kontributeve të pakthyera ishte 16,029 euro (2014: 13,688 euro).

## 11 RIVLERËSIMI I INVESTIMEVE TË DISPONUESHME PËR SHITJE - NETO

	Shënime	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Vanguard – GSIF	6.1	6,014,502	30,011,423
BNY Mellon – RRF	6.2	4,483,696	8,020,089
AXA – GILB	6.3	(796,761)	5,462,474
Schroders – SISF	6.4	(2,943,483)	3,137,067
Aquila – RP7	6.5	44,541	1,817,045
Nordea 1 - GSEF	6.6	7,390,692	5,304,385
Nordea 1 - SRF	6.7	4,836,923	4,812,922
KBI - IDPDEF	6.8	4,403,728	4,075,341
AXA - WFOI	6.9	1,737,267	348,852
Pictet - HDS	6.10	2,759,367	197,501
Tobam - ABWEF	6.11	(1,217,672)	1,748,152
ECM – DEC <sup>1</sup>		-	856,706
<b>Rritja neto për vitin nga rivlerësimi i investimeve të disponueshme për shitje</b>		<b>26,712,800</b>	<b>65,791,957</b>

<sup>1</sup> Gjatë 2014 FKPK i ka tërhequr në tërësi investimet në ECM-DEC.

## 12 TË HYRAT NGA INTERESI I INVESTIMEVE QË MBAHEN DERI NË MATURIM

	Shënime	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Afatizimet	7	17,096	-
Fletobligacinet e Thesarit të Kosovës	7.3	1,659,750	952,061
<b>Gjithsej të hyrat nga Interesi i investimeve që mbahen deri në maturim</b>		<b>1,676,846</b>	<b>952,061</b>

## 13 TË HYRAT E TJERA

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2015 Bordi Drejtues i FKPK-së kishte **vendsour t'i** refondojë tek mjetet Pensionale 1,055,000 euro nga suficiti i FKPK-O për aktivitetet investuese.

#### 14 TARIFAT E NGARKUARA MBI LLOGARITË E PJSËMARRËSVE

	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Tarifa për aktivitetet investuese	4,718,409	3,976,844
Tarifa për aktivitetet operacionale	1,101,069	1,292,475
<b>Gjithsej tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve</b>	<b>5,819,478</b>	<b>5,269,319</b>

Tarifat llogariten në baza ditore sipas formulës:

$$\text{Tarifa} = [\text{Mjetet bruto të pjesëmarrësve}] * [\text{Norma}] / [\text{Numri i ditëve kalendarike në vit}].$$

Gjithsej tarifa e ngarkuar mbi mjetet bruto të pjesëmarrësve me qëllim të financimit të aktiviteteve të FKPK-së për fundvitin 31 dhjetor 2015 ishte 5,819,478 euro (2014: 5,269,319 euro).

Për vitin e përmbyllur më 31 dhjetor 2015, tarifat vjetore të ngarkuara në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-168 ishin: a) nga 1 janari 2015 deri më 12 mars 2015: 0.400% për aktivitetet investuese dhe 0.130% për aktivitetet operacionale; b) nga 13 marsi 2015 deri më 31 dhjetor 2015: 0.400% për aktivitetet investuese dhe 0.085% për aktivitetet operacionale. Tarifat i miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës.

#### 15 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJSËMARRËSVE

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	Numri i llogarive	Numri i llogarive
Llogari pa tërheqje të kursimeve	478,982	452,011
Llogari me tërheqje të kursimeve	28,981	24,548
<b>Gjithsej llogari</b>	<b>507,963</b>	<b>476,559</b>

Një llogari me tërheqje të kursimeve paraqet llogaritë e kursimeve pensionale prej të cilave janë tërhequr kursimet pensionale për shkak se: (i) pjesëmarrësi ka arritur moshën e pensionit (65 vjeçare) ose është bërë i paafte për punë, ose (ii) pasardhësit, të konsideruar si trashëgimtarë të ligjshëm, kanë trashëguar kursimet pensionale të pjesëmarrësit të vdekur. Nga 507,963 pjesëmarrësit për të cilët FKPK-ja kishte hapur llogari të kursimeve pensionale deri në datën e raportimit, 297,466 sosh kishin kontributë që i përkisnin vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2015 (31 dhjetor 2014: 285,914 nga 476,559 llogaritë e hapura).

Kontributet në FKPK paguhën nga punëdhënësit në emër të të punësuarve të cilët janë rezidentë të Kosovës, me normën e kontributimit prej së paku 5% të të ardhurave bruto të punonjësit për të dy, punëdhënësin dhe të punësuarin. Së bashku me kontributet vullnetare, maksimumi që punëdhënësi dhe i punësuarit secili mund të kontribuojnë është 15% e të ardhurave bruto të punonjësit.

Punëdhënësit kanë për obligim të ngarkojnë në portalin e ATK-së listën e pagave në mënyrë që të sigurojnë fletëpagesën për një muaj të caktuar. Të vetëpunësuarit i bëjnë pagesat në baza tremujore. ATK-ja i mundëson FKPK-së të ketë qasje në këto shënime duke qenë gjithashtu përgjegjëse për përmbushjen e obligimeve të punëdhënësve, si dhe për sforcimin e përmbushjes përmes lëshimit të gjobave ndaj punëdhënësve delikuentë.

## 15 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJESËMARRËSVE (VAZHDIM)

Kryesisht për shkak të natyrës jo të përsosur të procesit të mbledhjes dhe raportimit që ishte në fuqi para tremujorit të katërt të vitit 2012, kur u shfaq portali i ATK-së, fondet e mbledhura nuk alokoheshin plotësisht në llogaritë individuale të pjesëmarrësve. Që nga koha kur portali u shfaq shumica dërrmuese e kontributeve janë duke u alokuar në llogaritë individuale në të njëjtën ditë kur pagesat procesohen. Kryesisht për shkak të mos-raportimit të punëdhënësve për periudhat e mëparshme, shuma prej 9,971,270 euro nuk ishte e shpërndarë në llogaritë individuale të pjesëmarrësve më 31 dhjetor 2015 (31 dhjetor 2014: 10,795,420 euro).

Gjatë vitit 2015 FKPK-ja e alokoi shumën prej 1,107,600 euro në llogaritë individuale nga shuma që ishte e paalokuar më 31 dhjetor 2014.

Natyra dhe arsyet e mos-alokimit të kontributeve në llogaritë individuale të pjesëmarrësve janë si në vijim:

Arsyet	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Punëdhënësit nuk kanë dorëzuar raportin e kontributeve	8,872,705	9,711,948
Pagesa nuk është alokuar në konto të punëdhënësit	564,039	571,236
Kombinime jo valide të Nr. personal, emrit/mbiemrit të pjesëmarrësit	534,526	512,236
<b>Gjithsej kontribute të paalokuara</b>	<b>9,971,270</b>	<b>10,795,420</b>
Kontributet kumulative të njësuara deri në datën e raportimit	1,110,907,262	973,387,646
<b>Kontributet e paalokuara si përqindje e kontributeve të njësuara deri në datën e raportimit</b>	<b>0.9%</b>	<b>1.1%</b>

Një metodë tjetër e vrojtimit të progresit të procesit të alokimit është krahasimi i fondeve të alokuara dhe mjeteve neto nën menaxhim të njësuara, si në vijim:

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
		Vlera në EUR	Vlera në EUR
Mjetet neto të pjesëmarrësve		1,238,091,732	1,095,744,756
Kontributet e arkëtueshme të panjësuar në datën e raportimit	5	(8,758,404)	(7,984,158)
<b>Mjetet neto të njësuara të pjesëmarrësve</b>		<b>1,229,333,328</b>	<b>1,087,760,598</b>
Bilanci i fondeve në llogaritë individuale		1,216,855,182	1,074,489,956
<b>Përqindja e mjeteve neto të njësuara të pjesëmarrësve në llogaritë individuale</b>		<b>99.0%</b>	<b>98.8%</b>

## 16 TËRHEQJA NË FAZA E BENEFITEVE

Sipas Rregullores për tërheqje të kursimeve pensionale, të ndryshuar nga BQK-ja në nëntor 2014 dhe të implementuar nga FKPK në janar 2015, pjesëmarrësit që me rastin e pensionimit në llogaritë e tyre në FKPK kanë bilanc më të lartë se pragu prej 2,250 euro duhet t'i tërheqin kursimet e tyre në fazë, mirëpo kanë edhe opcionin që 20% të bilancit ta tërheqin menjëherë (2014: pragu prej 2,000 euro pa opcion për të tërhequr asnjë pjesë të mjeteve me pagesë të menjëhershme). Pjesëmarrësit pranojnë pagesa mujore në shumën prej 1% të vlerës së përgjithshme të llogarisë së tyre në momentin e pensionimit ose 150 euro, cilado që është më e lartë. Rregullat mbi tërheqjet në fazë vlejné përdërisa anuitetet nuk ofrohen në Kosovë. Në momentin e pensionimit i gjithë bilanci i llogarisë së pjesëmarrësit, minus pjesën e tërhequr menjëherë, transferohet në bankën komerciale të kontraktuar për të ofruar shërbimin e tërheqjes në fazë, dhe mjetet e tilla nuk llogariten më si mjete të FKPK-MP. Personat që në momentin e pensionimit kanë bilanc më të ulët sesa pragu vazhdojnë t'i përfitojnë kursimet në një pagesë të vetme.

#### 17 PASQYRA E LËVIZJEVE SË AKSIONEVE TË PJESËMARRËSVE

	Shënime	2015	2014
		#	#
<b>Më 1 janar</b>		<b>844,608,178</b>	<b>753,650,392</b>
Aksionet e emetuara për kontributet e arkëtuara		103,533,820	103,569,706
Aksionet e riblera për shkak të tërheqjeve të kursimeve		(14,499,644)	(11,517,186)
Aksionet e riblera për shkak të refondimeve		(288,382)	(1,094,734)
<b>Më 31 dhjetor</b>		<b>933,353,972</b>	<b>844,608,178</b>
Neto mjetet e njësuara të pjesëmarrësve	15	1,229,333,328	1,087,760,598
<b>Vlera e mjeteve neto për aksion në datën e raportimit</b>		<b>EUR 1.3171</b>	<b>EUR 1.2879</b>

#### 18 NGJARJET PAS PERIUDHËS SË RAPORTIMIT

Për dy muajt e parë të vitit 2016 FKPK-MP i kishte këto të dhëna financiare të bazuara në pasqyrat e paaudituar financiare për këta dy muajt.

	Më 29 shkurt 2016
	EUR
Gjithsej mjete	1,234,729,122
Gjithsej detyrime (afat-shkurtëra)	(443,707)
<b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>1,234,285,415</b>
	Për periudhën 1 janar deri 29 shkurt 2016
	EUR
Fitimi dhe interesat nga rivlerësimi i investimeve	(22,456,273)
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	(957,238)
<b>Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>(23,413,511)</b>

Nuk ka ngjarje të tjera të mëvonshme që do të kërkonin korrigjim ose shpalosje të mëtejshme në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015.